



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr 38 date 15/03/2001

**PER  
VENDOSJEN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENSIVE TE SHERBIMIT  
FUNERAL NE QYTETIN E TIRANES**

Mbështetur në ligjin Nr.113/2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në Ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000 “**PER ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE**” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Agjensitë e licënuara nga Ministria e Punëve Publike për kryerjen e shërbimeve funebër të shpërndahen në mënyrë sa më uniforme në territorin urban të qytetit të Tiranës
2. Mjetet teknologjike (makinat e transportit të kufomave) gjatë kohës që nuk janë në shërbim, të parkohen vetëm në vende të paracaktuara dhe miratuara nga Bashkiak e Tiranës, duke mënjanuar parkimin në vende publike
3. Bashkia e Tiranës ose institucionet e deleguara prej saj, duhet të bëjnë kontrollimin dhe verifikimin e dokumentacionit të subjekteve private, që ushtrojnë këtë lloj aktiviteti
4. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike mdhe Drejtoria e Ndërmarrjes së Shërbimit Funeral

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**